



Prishtinë: 27.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1222_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2005_12_19**.

në seancën e mbajtur më datë 27.12.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht** ankesa e konsumatorit B.P. nga Komuna e Dragashit si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. OBLIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DPZ- 9023967 t'i anulojë korrigjimin plotësues nr.51487DPZ-9023967 të datës 28.02.2018 në vlerë 7,858.51€.
- III. OBLIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DPZ- 9023967 t'i bëjë korrigjimin plotësues për periudhën 18.09.2017 - 22.01.2018 me diferencën e mesatares në mes periudhës 10/2017-01/2018 dhe mesatares 10/2018-01/2019, për energjinë aktive, reaktive dhe fuqisë.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji është parashtruar ankesa nga A.P. NTP "MEKA" me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr.51487DPZ-9023967 të datës 28.02.2018, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 18.09.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja GM-njehsori elektrik nr. 96257409 me gjendje të shpenzimeve të energjisë elektrike aktive TL=12448.308 kWh dhe TU=4032.885 kWh, energjisë reaktive R1=4229,675 kVAr dhe R2=2396.406 kVAr, konstanten llogaritëse C=120 si dhe gjendjen e maksigrafit TL=0.5944 dhe TU=0.4740, dhe kanë vendosur për matje Grupin matës - njehsori elektrik nr.37438408 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000.365 kWh, dhe R1=000000 kVAr dhe R2=000000.222 kVAr, konstantën llogaritëse C=120, si dhe gjendjen e maksigrafit TL=0.0000 dhe TU=0.6180.

Provë: Procesverbali mbi montimin-demontimin- ndërrimin e grupit matës nr.024407 të datës 18.09.2017



Me datë 28.01.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e Grupeve Matëse kanë inspektuar GM nr.37438408 ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve TL=300.383 kWh dhe TU=109.426 kWh, si dhe R1=86.104 kVAr dhe R2=51.701 kVAr, konstanten llogaritëse C=120 si dhe gjendjen e maksigrafit TL=0.3552 dhe TU=0.2050. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që njehsori elektrik është i vulosur dhe se pas këputjes se vulës për korrigjimin e lidhjeve vërehet se dy rryma ne sekondar nuk kanë pasur kontakt (dy faza) nuk janë matur, përkatësisht nuk kanë regjistruar shpenzimin e energjisë elektrike. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se gjendja rregullohet dhe se pas rregullimit këto janë vlerat: L1= 239 V, L2=230 V dhe L3=230 kurse I1=92 A, I2=97 A dhe I3=116 A.

Provë: Raporti mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr.0055331 i datës 22.01.2018

Me datë 28.02.2018 Departamenti i faturimit në KESCO e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr.51487DPZ-9023967 në vlerë financiare **7,858.51€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 18.09.2017 deri me datë 22.01.2018.

Provë: Korrigjimi nr.51487DPZ-9023967 i datës 28.02.2018

Me datë 15.03.2018 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr.51487DPZ-9023967 të datës 28.02.2018.

Provë: Ankesa e konsumatorit ne KESCO e datës 15.03.2018

Me datë 03.04.2018 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe parametrat teknik te njehsorit elektrik nr. 37438408.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 03.04.2018

Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO, si dhe ka kërkuar t'i shqyrtohet korrigjimi plotësues nr.51487DPZ-9023967 të datës 28.02.2018.

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE

Bordi i ZRRE pas analizave të të gjitha dëshmimeve të paraqitura nga konsumatori dhe KESCO/KEDS, ka vërejtur se:

Me datë 18.09.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja GM-njehsorin elektrik nr. 96257409 me gjendje te shpenzimeve TL=12448.308 kWh dhe TU=4032.885 kWh, energjisë reaktive R1=4229,675 kVAr dhe R2=2396.406 kVAr, konstanten llogaritëse C=120 si dhe gjendjen e maksigrafit TL=0.5944 dhe TU=0.4740, dhe kanë vendosur për matje Grupin matës - njehsorin elektrik nr.37438408 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000.365 kWh, dhe R1=000000 kVAr dhe R2=000000.222 kVAr, konstantën llogaritëse C=120, si dhe gjendjen e maksigrafit TL=0.0000 dhe TU=0.6180.

Provë: Procesverbali mbi montimin-demontimin- ndërrimin e grupit matës nr.024407 i datës 18.09.2017

Me datë 28.01.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e Grupeve Matëse kanë inspektuar GM nr.37438408 ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve TL=300.383 kWh dhe TU=109.426 kWh, dhe R1=86.104 kVAr dhe R2=51.701 kVAr, konstanten llogaritëse C=120 si dhe gjendjen e maksigrafit TL=0.3552 dhe TU=0.2050. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që njehsori elektrik është i vulosur dhe se pas këputjes se vulës per korrigjimin e lidhjeve vërehet se dy rryma ne sekondar nuk kanë pasur kontakt (dy faza) nuk janë matur, përkatësisht nuk kanë regjistruar shpenzimin e energjisë elektrike. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se gjendja rregullohet dhe se pas rregullimit këto janë vlerat: L1= 239 V, L2=230 V dhe L3=230 kurse I1=92 A, I2=97 A dhe I3=116 A.

Provë: Raporti mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr. 0055331 datë 22.01.201



Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike per periudhën kontestuese vërtetohet se konsumatori ka rënie të shpenzimit të energjisë elektrike. Për këtë qëllim ZRRE ka bërë krahasimet e shpenzimeve të konsumatorit për periudha të njëjta kohore me dy njehsorët elektrik, me njehsorin e vjetër elektrik nr.96257409, si dhe njehsorin e ri elektrik nr.37438408 dhe konstaton se konsumatori ka ndryshim të shpenzimeve vetëm në periudhën kontestuese 09/2017 deri në periudhën 01/2018. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.96257409 për periudhën 10/2015 deri në periudhën 01/2016 është **30,417 kWh/muaj**, si dhe për periudhën 10/2016 deri në periudhën 01/2017 është **32,781.30 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 37438408 për periudhën 10/2017 deri në periudhën 01/2018 është **14,468.10 kWh/muaj** si dhe për periudhën 10/2018 deri në periudhën 01/2019 është **30,843 kWh/muaj**. Bazuar në këtë ZRRE konstaton se konsumatori ka rënie të shpenzimit me njehsorin e ri elektrik nr. 37438408 vetëm në periudhën kontestuese kurse në periudhën e mëvonshme shpenzimi përputhet plotësisht edhe me shpenzimet e mëhershme.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike

Me datë 28.02.2018 Departamenti i faturimit në KESCO bazuar në Raportin mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr.0055331 të datës 22.01.2018 ka bërë korrigjimin plotësues nr.51487DPZ-9023967 në vlerë **7,858.51€** për faturat e periudhës 18.09.2017 (nga vendosja për matje e njehsorit nr.37438408) deri me datë 22.01.2018 kur edhe është identifikuar problemi duke ri faturuar faturat e asaj periudhe me faktorin e korrigjimit $K=3$ për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik nr. 37438408. ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga KESCO dhe konstaton se KESCO ka gabuar pasi që ri faturimi i bërë për periudhën kontestuese nuk korrespondon me periudhat e mëhershme si dhe te mëvonshme te shpenzimit të konsumatorit. ZRRE duke marrë parasysh të gjitha faktet e në veçanti shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit konstaton se konsumatori duhet të lirohet nga korrigjimi plotësues nr.51487DPZ-9023967 në vlerë **7,858.51€** pasi që kjo nuk paraqet shpenzim të mundshëm real dhe se për këto periudha (18.09.2017 - 22.01.2018) konsumatori duhet të faturohet me diferencën e mesatares në mes periudhës 10/2017 -01/2018 dhe mesatares mujore të periudhës 10/2018-01/2019 për energjinë aktive, reaktive dhe fuqinë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: B.P. NTP “Meka”,
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.